



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 18.5.2023

Nr: 529

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E REZULTATIT TË VERIFIKIMIT TË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM PËR
SUBJEKTIN VETËDEKLARUES Z. SERDAR QEMAL HOXHA KANDIDAT PËR DEPUTET I
PROPOZUAR NGA PARTIA SOCIALDEMOKRATE, QARKU SHKODËR**

Sot më datë 18.5.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në seancë publike shqyrtova çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues z. Serdar Qemal Hoxha, kandidat i propozuar për deputet nga Partia Socialdemokrate, Qarku Shkodër, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Palë të interesuara: Z. Serdar Qemal Hoxha, kandidat i propozuar për deputet nga Partia Socialdemokrate, Qarku Shkodër, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021.

Baza ligjore: Nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 90 dhe 95 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, ligji nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pikat 12 dhe 13 të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”,

Data: 18.5.2023 Nr: 529
Ora:12:00



“Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues z. Serdar Qemal Hoxha, kandidat për deputet i Partisë Socialdemokrate, Qarku Shkodër”

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

VËREJ:

I.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte ndër të cilat është edhe "Kandidati për deputet".

Në zbatim të këtyre dispozitave, z. Serdar Qemal Hoxha, kandidat për deputet i Partisë Socialdemokrate, Qarku Shkodër, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, formularin e vetëdeklarimit me nr.1545 unik.

Përpara miratimit të listave të kandidatëve për deputetë për subjektin zgjedhor Partia Socialdemokrate, në bazë të kompetencave të veta, KQZ bëri verifikimin *prima facie* dhe pasi konstatoi se kandidati nuk është në kushtet e ndalimit, ndërmori hapat e mëposhtme:

- a. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 2191 prot, datë 17.03 2021, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, e cila nga ana e saj me shkresën nr. 2851/1 prot, datë 17.03.2021, ka dërguar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për Deputet z. Serdar Qemal Hoxha, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.
- b. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 2211 prot, datë 17.03 2021, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, e cila nga ana e saj me shkresën nr. 1156/1 prot, datë 08.04.2021, ka dërguar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e të dhënave për kandidatin për Deputet z. Serdar Qemal Hoxha, ku konstatohet se kandidati nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.

Pas verifikimeve të mësipërme, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 157, datë 17.03.2021, vendosi miratimin e listave shumëmemërore të Partisë Socialdemokrate, për Qarkun Shkodër për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021.

II.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", verifikoi të dhënat në formularin e vetëdeklarimit të kandidatit për deputet z. Serdar Qemal Hoxha.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Serdar Qemal Hoxha, rezulton se i është përgjigjur me "jo" të gjitha pyetjeve të formularit të vetëdeklarimit.

Referuar indicieve të subjektit zgjedhor Partia Demokratike, drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në përmbatje të të cilit pretendohet që z. Serdar Qemal Hoxha, është bashkëpunëtor i z. Doshi, dhe shoqërohet me shtetasin T.D i dënuar nga autoritetet gjyqësore italiane për trafik droge, si dhe bazuar në nenin 8, pika 1, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e Integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreu V, pika 2, shkronja “c”, të Vendimit të Kuvendit, nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 2685 prot., datë 25.03.2021, vendosi t’ia kalojë rastin për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, si institucioni kompetent që kryen verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra.

Me shkresën nr. 551/79 prot., datë 08.05.2023, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, vendimin “Për miratimin e rezultatit të verifikimit për subjektin z. Serdar Qemal Hoxha, Prokuroria e Përgjithshme pas kryerjes së gjithë verifikimeve përkatëse, i konsideron këto të fundit të plota dhe të bazuara në nenin 8, pikat 1 dhe 2, të lidhura me nenin 5 të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” si dhe në përcaktimet e pikës 3 shkronja “ç”, Kreu III dhe pikave 10, 11, 12 e 13 të Vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, ka miratuar rezultatit e verifikimit të subjektit vetëdeklarues z. Serdar Qemal Hoxha, sipas të cilit konstatohet si më poshtë:

- Nuk rezulton të ketë kryer ndryshime në përbërësit e gjendjes civile apo të ketë përdorur gjenealitete të tjera;
- Nuk rezulton të jetë dënuar, për kryerjen e një veprë penale me vendim të formës së prerë nga ndonjë autoritet gjyqësor;
- Nuk rezulton i dënuar me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor për një çështje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- Nuk rezulton të ketë qenë në hetim e gjykim, nga një autoritet për kryerjen e ndonjë veprë penale ;
- Nuk rezulton të ketë qenë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese për kryerjen e një veprë penale;
- Nuk rezulton t’i jetë caktuar masë shtrënguese e sigurisë personale ;
- Nuk rezulton të jetë lëshuar ndonjëherë ndaj tij urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale;
- Nuk rezulton të jetë marrë ndonjëherë për të masa e dëbimit nga një shtet i huaj, në lidhje me një prej rasteve të parashikuara në pikën 1, shkronjat “a”, “b” dhe “c” të nenit 2 të ligjit nr.138/2015 apo për cënim shumë të rëndë serioz të sigurisë publike;
- Nuk rezulton të ketë të tjera indicie apo të dhëna a rrethana, fakte të bëra publike apo informacion me qëllim verifikimi të mëtejshëm:
 - Për veprimtari kriminale të kryer jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
 - Për qënien nën hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj;

- Për urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e ndonjë vepre penale prej tij;
- Dëbime nga territori i ndonjë shteti jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
- Përdorimin e të dhënave personale/gjenealiteteve të tjera.

Nisur nga verifikimet e mësipërme rezultojnë se, kandidati për deputet i subjektit politik Partia Socialdemokrate Qarku Shkodër, nuk përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2 të ligjit 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë. Referuar të dhënave të disponuara, kandidati nuk është në kushtet e ndalimit të kandidimit/moszgjedhshmërisë.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 410, datë 23.06.2021 miratoi shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore, përcaktimin e kandidatëve fitues si dhe rirenditjen e kandidatëve, në zonën zgjedhore Qarku Shkodër, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25.04.2021. Partia Socialdemokrate ka fituar 2 (dy) mandate dhe z. Serdar Qemal Hoxha, kandidat i listës shumëmemërore të Partisë Socialdemokrate në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021, Qarku Shkodër, nuk ka marrë mandatin e deputetit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 90 dhe 95 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, ligjin nr.138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pikat 12 dhe 13 të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

V E N D O S:

1. Konstatimin se z. Serdar Qemal Hoxha, kandidat për deputet i subjektit zgjedhor, Partia Social Demokrate, Qarku Shkodër nuk përfshihet në kushtet e ndalimit për të ushtruar funksionin publik të deputetit.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI